



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

---

Numri i lëndës: 2019:272769

Datë: 14.03.2024

Numri i dokumentit: 05450193

KA.nr. 282/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Administrative, gjyqtari Arben Toska, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit “Prima-IR” Sh.P.K. me NUI 811014315 dhe seli në rrugën 28 Nëntori në Skenderaj, i përfaqësuar sipas prokurës nga avokati Ekrem Hoxha me seli në rrugën “Rexhep Luci” H I nr.5 në Prishtinë, kundër të paditurës Komuna e Skenderajt, Drejtoria e Inspektoratit, për shkak të anulimit të aktit administrativ, jashtë seancës më 11 mars 2024 mori këtë:

AKTVENDIM

Pezullohet procedura e konfliktit administrativ sipas padisë së paditësit “Prima-IR” Sh.P.K. me NUI 811014315, kundër të paditurës Komuna e Skenderajt, Drejtoria e Inspektoratit, për shkak të anulimit të vendimit me numër nr. 09-354/01-0030954/19 të datës 31.05.2019 të së paditurit.

ARSYETIM

Paditësi më 11.06.2019 ka ushtruar padi kundër të Paditurës me të cilën i ka kërkuar kësaj gjykate anulimin e vendimit me numër nr. 09-354/01-0030954/19 të datës 31.05.2019 të lëshuar nga i padituri.

Megjithatë Paditësi përmes parashtresës së datës 05.03.2024 e ka njoftuar gjykatën se e tërheq padinë e paraqitur më datë 11.06.2019, për këtë çështje të konfliktit administrativ.

Duke marr për bazë se sipas nenit 31 para.1 të LKA-së paditësi mund të heqë dorë nga padia derisa të mos merret vendimi dhe se në këtë rast gjykata e pezullon, gjykata vendosi si në

dispozitiv të këtij aktvendimi. Gjykata sheh të arsyeshme të sqaroj se, në konfliktit administrativ, sipas nenit të cituar më lartë, nuk kërkohet pëlqimi i të Paditurit për tërheqjen e padisë, rrjedhimisht nuk e mori mendimin e të Paditurit.

Për këto arsye gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Gjykata Komerciale e Kosovës

Dhomat e Shkallës së Parë Departamenti i Përgjithshëm

KA.nr.282/22

Gjyqtari

---

Arben Toska

UDHËZIMI PËR MJETIN E GODTIJES: Kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesa.